



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 145, datë 27.04.2020

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË PROGRAMIT KOMPJUTERIK “MICROSOFT TEAMS” QË MUNDËSON NDËRLIDHJEN AUDIOVIZIVE NË DISTANCË PËR ZHVILLIMIN E SEANCAVE GJYQËSORE, GJATË KOHËZGJATJES SË EPIDEMISË.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 147/1, 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 7, 36 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 42 të Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si dhe në nenin 4 të Aktit Normativ nr.9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, me propozim të Komisionit të Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.135, datë 16.04.2020,

VE ND O S I:

1. Miratimin e përdorimit të programit kompjuterik “Microsoft Teams”, për të siguruar në mënyrën më të sigurtë të mundshme, ndërlidhjen audiovizive në distancë dhe pjesëmarrjen e të paraburgosurit/të dënuarit dhe përfaqësuesve ligjorë të tyre, në të gjitha seancat gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë.
2. Ky program siguron shikueshmërinë e ndërsjellë të personave të pranishëm në të gjitha vendet e ndërlidhura dhe mundësinë e dëgjimit nga të gjitha palët. Për të garantuar mbrojtjen efektive dhe të drejtat e të paraburgosurit/të dënuarit, përfaqësuesve ligjorë që ndodhen në sallën e gjyqit u garantohej komunikimi privatisht me të paraburgosurin/të dënuarin nëpërmjet telefonit. Pjesëmarrja e të paraburgosurit/të dënuarit në seancën gjyqësore në distancë duhet të bëhet nga adresa e emailit të institucionit ku mbahet paraburgosuri/i dënuari.
3. Nëse parashikohet pjesëmarrja e disa të pandehurve, që ndodhen në institucione të ndryshme të vuajtjes së dënimit, secili prej tyre duhet të vendoset në kushte që të mund të shikojë dhe të dëgjojë të tjerët, ndërsa pjesëmarrja e tyre në seancën gjyqësore në distancë duhet të bëhet nga adresa e emailit të secilit institucion.

4. Fillimisht, përdorimi i kësaj platforme, deri në një moment tjetër, mundësohet vetëm në ato çështje ku parashikohet pjesëmarrja e jo më shumë se 5 (pesë) palëve.
5. Ngarkohen specialistët e IT në gjykata dhe ata të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që për përdorimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams”, të bashkërendojnë punën për instalimin e këtij programi në sallat e gjykimit, si dhe për dhënien e asistencës teknike gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR